



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3850/16 Prot.

Pogradec, më 04.11.2025

VENDIM

NR. 96, DATË 31.10.2025

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25.09.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 25.09.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 25.09.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1. Miratuar me 23 vota

2. Vota Pro 23

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 04.11.2025



Data. 25.08.2025

	Emri	Atesia	Mbiemri	Subjekti	Prezenca
1	Frederik	Mico	Pikuli	BF	1
2	Marjeta	Feim	Biba	BF	2
3	Ervin	Shpetim	Mancellari	BF	3
4	Albana	Vladimir	Prifti	BF	4
5	Klajdi	Albert	Gjona	BF	M
6	Manjola	Petraq	Kamolli	PSSH	5
7	Odhise	Refik	Mihallari	PSSH	M
8	Brunilda	Merdan	Gora	PSSH	6
	Sara	Agim	Olldashi	PSSH	7
10	Klea	Edmond	Topa	PSSH	8
11	Ylli	Xhelal	Kasmollari	PSSH	M
12	Silvana	Nikollaq	Bozda	PSSH	9
13	Besnik	Bedri	Xhyra	PSSH	M
14	Mimoza	Feti	Shulli	PSSH	M
15	Jovan	Filip	Shkembali	PSSH	10
16	Anila	Mihallaq	Gjoshe	PSSH	11
17	Ahmed	Perparim	Guxholli	PSSH	12
18	Miranda	Fidari	Olldashi	PSSH	M
19	Mentor	Idriz	Rama	PSSH	M
20	Elsona	Sotiraq	Turshinka	PSSH	13
21	Celnik	Rushit	Haxhillari	PSSH	14
22	Vjollca	Tefik	Pllaha	PSSH	15
23	Genci	Hamdi	Zyferi	PSSH	16
24	Kejvi	Musa	Abrashi	PSSH	M
25	Diogjen	Zarif	Qeva	PAA	17
26	Zhaneta	Arif	Elezaj	PAA	18
27	Engjell	Fluturak	Shyti	PD	19
28	Alketa	Kujtim	Beka	PD	20
29	Arber	Myzafer	Male	LZHK	M
30	Liri	Neki	Seitllari	LZHK	M
31	Suferin	Axhi	Dokollari	FRD	M

Enleu

atyplo kauli

by

by

by

by

by

by

by

by

by

by

by

by

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09.2025

ORA : 12:00

JANË PREZENT 20 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE
25.09.2025 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 28.08.2025.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.08.2025.
5. **Projekt – Vendim :** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Gusht 2025.
6. **Projekt – Vendim :** Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Pogradec (faza II)
7. **Projekt – Vendim :** Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore,artistike dhe sportive.
8. **Projekt – Vendim :** Për kriteret, procedurat e dhënies së titujve të nderit si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec.
9. **Projekt – Vendim :** Për miratimin e bonusit të qerasë për Z.Agron Lipo në Bashkinë Pogradec.
10. **Projekt – Vendim :** Për miratimin e bonusit të qerasë për Z.Përparim Shkullaku në Bashkinë Pogradec.
11. **Projekt – Vendim :** Për miratimin e bonusit të qerasë për Z.Avni Muco në Bashkinë Pogradec.
12. **Projekt – Vendim :** Për miratimin e bonusit të qerasë për Z.Shkëlqim Zyko në Bashkinë Pogradec.
13. **Projekt – Vendim :** “Për dhënie ndihmë financiare për Znj. Luiza Mara ”
14. **Projekt – Vendim :** Per miratimin e bonusit të qerasë për z. Refat Bufi në Bashkinë Pogradec.
15. **Projekt – Vendim :** Per miratimin për strehim të përkohshëm së znj Elvira Rovi në banesën sociale në pronësi të Bashkisë Pogradec.
16. **Projekt – Vendim:** Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkuar për ndërtim fotovoltaike(stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m2 (treqind e tremijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntëmijë) m2.
17. **Projekt – Vendim:**Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.
18. Raportim nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit per punën e kryer gjatë peeuudhës Janar-Gusht 2025 dhe planifikimet deri në muajin Dhjetor 2025 .
19. Të tjera.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09.2025

1. "Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 4 dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr 40, ligji 139/2015".

Znj.Manjola Kamolli (Kryetare e Këshillit) Përshendetje , sot jemi mbledhur në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Materialet janë dërguar në mënyrë elektronike dhe në hard copy.Vazhdojmë me prezencën.

Pa humbur kohë po vazhdojmë me rendin e ditës duke hedhur një nga një pikat shtese.

Kryetarja Znj Manjola Kamolli lexon Projekt-Vendimet shtese per te kaluar ne votim.

Diskutime

Projekt –Vendimi Nr 13: Miratohet me 20 vota Pro

Projekt –Vendimi Nr 14: Miratohet me 20 vota Pro

Projekt –Vendimi Nr 15: Miratohet me 20 vota Pro

Projekt –Vendimi Nr 16 : Miratohet me 17 vota Pro, 1 Abstenim, 1 kunder (Largohet S.Bozdo)

Projekt –Vendimi Nr 17: Miratohet me 15 vota Pro 3 Abstenim 2 kunder (Vjen S. Bozdo dhe Sara Olldashi)

Znj Kryetare sqaron qe po votohet per te hyre ne Rendin e dites.

Hidhet ne votim Rendi I dites.

U votua

Pro 18

Kundër 0

Abstenim 1 (Ervin Mancellari)

Miratohet Po Jo

JulB

Mbledhje e Këshillit Bashkiak


Pogradec më 25_. 09. 2025

2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Diskutime

Znj.M.Kamolli: Deklarimi I konfliktit të interesit është një proces rutinë që bëhet në fillimin e çdo mbledhje. Nqs dikush ka konflikt interesi duhet ta deklaroje .

Nuk ka asnjë këshilltar që të ketë konflikt interesi.



 Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25 . 09 . 2025

3. “ Miratimi i Procesverbalit te datës 28.08.2025.

Diskutime

Znj M.Kamolli : Procesverbal i mbledhjes së datës 28.08.2025 është dërguar , nqs dikush nuk ka dicka për të diskutuar e hedhim në votim

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo





Mbledhje e Këshillit Bashkiak


Pogradec më 25. 09. 2025

4.Pika : Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 28.08.2025.

Diskutime

Znj.Kryetare lexon Konfirmimin e Institucionit të Prefektit me nr 798 /1 Prot.

Vendimet e mbledhjes së datës 28.08.2025 janë konfirmuar të gjitha.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.05. 2025

5.Pika . Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Gusht 2025.

Diskutime :

(Largohet S. Bozdo , prezent 19 Këshilltarë)

Zn M.Kamolli: Ky është një projekt-vendim rutinë që miratohet cdo muaj. Po ja jap fjalën drejtorëshës për ta sqaruar me pak fjalë projekt-vendimin.

I.Lakmani: Për muajin Gusht jane rekomanduar te trajtohen 170 familje procedura eshte e njejte kemi +- dy tre familje.

Znj Kryetare : Nqs nuk ka dikush tjetër për të thënë e hedhim në votim.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



6. Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 te Bashkisë Pogradec (faza II)

Znj.Kamolli: drejtoresha eshte e justifikuar sot per arsyje familjare ja japim fjalën Specialistes së Financës Znj.Hafesllari.

Diskutime

Znj.Hafesllari : Programi buxhetor afatmesem 2026-2028 eshte realizuar në mbështetje të nenit8,pika 2,nenit 9, pika 1 ,nënpikat 1.1 shkronja b , dhe nënpikat 1.3, shkronja c, nenit 34 ,pika 6 nenit 41 pika 1 dhe pika 2 shkronja d, nenit 54 shkronja dh dhe nenit 55 pika 3 dhe pika 66 ne mbështetje të ligjit nr.139/2015 në zbatim të udhezimit nr 8 dt 28.02.2025 të Ministrisë së Financave .Njësia Vetëqeverisëse Vendore ka përfunduar Fazën e Dytë të përgatitjes së prgramit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për periudhën 2026-2028.

Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi Përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor.

Faza e II e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Disa nga këto rekomandime janë:

Të rritet performanca , të rritet pesha që shpenzimet për investimet zenë në buxhetin e Bashkisë, të hartohet plani i shlyerjes së detyrimeve.

Drejtoria e Financës ka hartuar një plan për shlyerjen graduale të detyrimeve të prapambetura.

Znj.Kryetare.Faleminderit e mer fjalën Z.Haxhillari na prezanton me Relacionin për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 Faza II

C. Haxhillari: PBA prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithësej dhe përcakton objektivat përse do shpenzohen ato.Në të njëjtën kohë ai synon të garantojë që shpenzimet publike vendore plotesojnë nevojat në rritje të banorve. Po ju prezantojmë në një mënyrë më të përmbledhur Programin Buxhetor Afatmesëm ku përfshin disa procese;

Prezanton iformacion mbi te ardhurat dhe bburimet e disponueshme të Bashkisë

Përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së

Shpërndan burimet sipas fushave të vecanta

Përcakton treguesit e performancës

Llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve

Përcakton treguesit Vjetor të Performancës në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi

Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit

Planifikimi i shpenzimeve të programit

Mbi bazën e këtyre parimeve është hartuar edhe programi buxhetor afatmesëm për periudhën 2026-2028.

Ajo që ne duhet të theksojmë është se në listën e paraqitur ka programe të përfshira, në programin kryesor të Bashkisë Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi dhe në programin e detajuar perkatës shifrat janë më Zero. kjo nuk do të thotë që sfunksionin shërbimi por ky shërbim nuk është i vecantë sic janë : Rubrikat kryesore.

Duke patur parasysh që jemi thjesht në fazën e II-të ku kjo fazë nuk ka ndryshuar nga faza e I-rë të cilën ne e kemi diskutuar ju propozoj të miratojmë këtë Projekt-Vendim.

Znj.kryetare ja jep fjalën Znj Bibës.

Znj Biba: Unë kam qënë pjesë e konsultimit dhe bëmë disa sygjërime , programi është goxha i bollshëm dhe mjaft i qartë dua ta di a janë marë parasysh këto sygjërime që ne kemi bërë sepse po shoh që nuk janë të shënuara dhe kjo do ndodhë si vitin e kaluar ku kalojnë fondet dhe i ndryshojme si Psh për Përronin e Caprazit duhet të specifikohet.

Fjala kalon tek Znj. Beka

A.Beka : Edhe unë isha pjesë e konsultimeve dhe kërkesat që u paraqitën nga banorët janë pjesa e buxhetit që këshillimet janë në total edhe ato nuk mund ti ndajmë.

Z.Mancellari: A është marë parasysh ne Njësinë Administrative Bucimas Dardhas ,Proptisht dhe Trebinjë që në fondin që do kalojë do ketë ndonjë investim ekstra për këto zona? Nuk ka rëndësi kush e fitoi e kush e mbaroi këto zona ndoshta kanë nevojë për ndricim për pyllëzim për tabela ashtu sic e ka bërë Zoti Zeqollari dhe e falenderoj.Të bëhët nga Bashkia me një lloj emërtimi një lloj gjelbërimi ose ndricimi. Për këtë jam i interesuar dhe do desha edhe nga kolëgët e mi të Këshillit të meret pak kjo kërkesa për ndarjen e fondit për njësitë administrative. Faleminderit.

Znj.Kryetare e jep fjalën tej Znj.Elezaj

Znj Elezaj. Është bërë një kërkesë e vazhdueshme për rehabilitimin e lagjes 1 për mbetjet Inerte .Ajo eshte nje zonë cop cop , po flasim për sheshin që del tek Rruga Industriale.



Znj.Kryetare : Të gjitha këto ishin dhe tek Konsultimi Publik mesa e lexova por me duket se keto defajime bëhen në fazën e buxhetit të pyesim një specialist. Konsultimet për Buxhetin do ti kryejmë së shpejti por edhe këto patjetër që janë shënuar edhe duhet të meren parasysh.

Znj.Elezaj dua të theksoj që ndërtesa e Ish Gjeologjisë e cila është problematike që të shëmbët është në mes të qytetit, të gjitha ndërtesat që po rehabilitohen u dha ceku dhe u anulua.

Znj.Kryetare : Jo nuk u anulua sepse unë e di që ajo është kthyer nga Prefektura sepse nuk është pronë e bashkisë.

Znj.Eleza: Ok në rregull kush e ka këtë pronë dhe pse Bashkia nuk ndërhy.

Znj.Kryetare: Unë nuk mund të jap këtë përgjigje tani këtu, ti po flet për kërkesat kur ne po miratojmë Programin Buxhetor.

Znj.Elezaj: Unë po flas për problematikat, gjithmonë duke bërë kërkesë

Znj.Kryetare : Ne po miratojmë programin Buxhetor afatmesëm 2026-2028 .

E mer fjalën Z.Male

A.Male : Meqë jemi tek buxheti unë kisha një shqetësim për Këshillin Bashkiak sepse është viti i tretë që Këshilli nuk mer as një fond.

Znj.Kryetare Unë jam interesuar personalisht për këtë çështje.

Z.Male : Kemi një kakofoni këtu në mbledhje, zërat nuk dëgjohen dhe më vjen dhe si për të qeshur se sa po më ndodhi karrigja ku unë jam ulur është e prishur, karrige të thyera të dëmtuara , erdhën disa ndihma para disa kohësh për Këshillin Bashkiak ikën përsëri.Gjithsesi ne kemi fond cdo Vit për Këshillin Bashkiak ju lutem izaaroni atë që na takon.

Znj.Kryetare: Për mikrofonët kanë kaluar në Prokurim Publik me sa di unë.

Z.Male : Kështu na thatë edhe vjet,shpresoj që herës tjetër të kemi dicka konkrete.

Znj.Kryetare: Z.Male në javët në vazhdim do të organizojmë një sesion të hapur ku do tju prezantojmë se çfarë bën Këshilli Bashkiak, kompetencat. Arbër nuk dua të dal nga tema kërkuam një fond të vogël për postera,bamera edhe flet palosje ne e bëmë kërkesën djë dhe u treguan shumë të gatshëm.



Z. Malaj: Kjo është salla jonë edhe ne duhet të jemi më kërkuar se e përdorim ne.

Znj. Kryetare: Kjo sallë nuk përdoret vetëm nga ne por kjo është një diskutim tjetër edhe pse unë nuk jam dakort.

Z. Haxhillari: Këto janë detaje specifike që nuk kanë lidhje me programin.

Znj. Kryetare: Po janë detaje specifike do diskutohen një herë tjetër.

Mendoj të kalojmë në miratimin e Planit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 të Bashkisë Pogradec (faza II). Hedhim në votim pikën 6 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo





Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09. 2025

7. Miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike dhe sportive

Diskutime

Znj Kryetare I jep fjalën përfaqësuesit për të prezantuar me pak fjalë Projekt- Vendimin

Znj Alda Oparaku: Hartimi I kësaj rregulloreje siguron transparencë , konkurrencë të ndershme në aktivitete kulturore , sportive dhe artistike si dhe domosdoshmërinë e një kuadri të qartë rregullues menduam të vinim në Këshill me këtë projekt-vendim mbi të cilat mbështeten të gjitha procedurat. Bashkia Pogradec nëpërmjet Qendrës Multifunksionale Pogradec Sha, në kuadër të kompetencave si dhe referuar aktit të themelimit dhe statutit, kanë për detyrim të mbështesin zhvillimin e jetës kulturore, sportive dhe artistike, si një element themelor I përfshirjes sociale dhe I identitetit komunitar. Përvec projekteve që realizohen nga artistët e qendrës Kulturore, “Lasgush Poradeci” dhe Drejtoria e Sporteve , në kuadër të sezonit turistik dhe pasurimin e jetës kulturore- artistike- sportive, lind nevoja që të miratohen dhe projekte të cilat zhvillohen nga organizata jofitimprurëse, institucione, shoqata sportive, grupe të pavarura apo individë krijues Brenda territorit të Bashkisë.

F. Pikuli: Formati I hartimit të rregullores nuk është në rregull. Së pari nuk ma ze syri , së dyti në rregullore nuk ka vendimarrje pra përdorimi I fjalës, vendosi.

K.Topa: Po duhen bërë disa rregullime në fakt kur të zbardhet vendimi, pra propozoj ta miratojmë me ndryshim:

-Rregullorja të ndahet nga projekt- vendimi dhe në rregullore të hiqet fjala, vendosi.

-Rregullorja te filloje me qëllimin, objektivin.

-Të vendosen nenet.

M. Kamolli: Të hidhet ne votim me ndryshime

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09.2025

8:Për kriteret, procedurat e dhënies së titujve të nderit si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec..

Znj Kryetare : Ne kishim një rregullore ekzistuese por bazuar në ligjin e ri znj Gusheo përgatiti një rregullore të re e cila u diskutua, shumë faleminderit për punën për detajet. U diskutua paraprakisht në komisionet dhe cdo gjë ishte hartuar në perfeksion . Shkurtimisht znj Gusheo.

Znj.Gusheo: Shumë shkurtimisht unë ju përshëndes dhe shumë faleminderit. Në këtë rregullore janë shtuar edhe emrat e shesheve, rrugëve dhe institucioneve, meqenësë është një rregullore shumë e rëndësishme dhe preken shumë individë të cilët do të marrin Tituj Nderi apo emra në vazhdimësi. Ne diskutuam një Projekt për rregulloren e Titujve të Nderit pasi morëm miratimin e kaluam në rregullore për ta miratuar ju. Përfitoj me këtë rast në këtë mbledhje që personat që do të zgjidhen ose do të propozohen të jenë konform kriterëve që janë në rregullore nëqoftëse ju do ta aprovonë. Që të mos kemi refuzime dhe komente nga pas. Në qoftëse ka ndonjë pyetje për rregulloren mund ta drejtoni.

Z.Mancellari : Mund të më jepni një kopje të kësaj rregullore.

Zj Kryetare: E ke të bashkangjitur.

Z.Mancellari: Nuk e kasha dokumentin të dërguar në hard copy.

Znj Kryetare: E vetmja gjë që po mendoja mos duhet të shkruajmë tek vendimi që të gjitha rregulloret e mëparshme shfuqizohen sepse ne e kishim një rregullore.

Znj Prifti: L idhur me propozimet që kam bërë unë si Këshilltare për z.Muharrem Xhukollarin besoj është në procedurë verifikimi si do quhet ky si propozim dhe propozimin për çiftin Bego. Kur kam bërë propozimet më thanë që kur të bëhet rregullorja e re nuk do bëhet më propozim por do përcillet dokumentacioni.

Znj Gusheo unë mendoj dhe ky është mendimi im personal gjithcka të filloj me një rregullsi dhe korrektësi në bazë të rregullores që do të aprovojmë tani nëse ju e votoni.

Znj Kryetare : Këtë do të thoj, që të lexoni me shumë kujdes rregulloren.



Znj Prifti: Unë e kam lexuar me shumë kujdes rregulloren por propozimi është bërë dhe nuk është që do të bëhet prap. Tani meqënëse Z.Bego ka 100 vjetorin e lindjes une propozova edhe vitin e kaluar tja japim titullin.

Znj Kryetare: Ju po flisni me emra konkretë ju lutem nuk I mësuat rregullat kërkesat janë në fund tani po flasim parimisht kurse kjo është një kërkesë specifike.

Znj Kryetare: Vazhdojmë hedhim në votim rregulloren ju lutem .

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09.2025

9. Për miratimin e bonusit të qerasë për Z. Agron Lipo në Bashkinë e Pogradecit

Diskutime

M.Kamolli: Vazhdojme me Projekt - vendimin e rradhës. Jeni dakort?

E hedhim në votim ju lutem!

U votua

Pro 19 vota

Kundër 0 vota

Abstenim 0 vota

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09.2025

10: Për miratimin e bonusit të qerasë për Z. Përparim Shkullaku në Bashkinë Pogradec.

Diskutime:

Znj. Kryetare : Nqs nuk keni dicka për të shtuar e hedhim në votim pikën 10 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09. 2025

11. Për miratimin e bonusit të qerasë për Z. Avni Muco në Bashkinë Pogradec.

Diskutime:

Znj. Kryetare : Hedhim në votim pikën nr 11 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet për shtyrje Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09. 2025

12. Për miratimin e bonusit të qerasë për Z. Shkëlqim Zyko në Bashkinë Pogradec

Diskutim:

M.Kamolli: Hedhim në votim pikën 12 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09.2025

13: Për dhënie ndihmë financiare për Znj. Luiza Mara

Diskutim:

Znj.Kryetare : Hedhim në votim pikën 13 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09. 2025

14: Për miratimin e bonus të qerasë për Z. Refat Buri në Bashkinë Pogradec.

Diskutim

Znj.Kryetare : Hedhim në votim pikën 14 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09. 2025

15: Për miratimin për strehim të përkohshëm së Znj.Elvira Rovi në banesën sociale në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Diskutim

Znj.Kryetare : Hedhim në votim pikën 15 të rendit të ditës.

U votua

Pro 19

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09. 2025

16: Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera.

Diskutim

Znj. Biba: Znj Kryetare secili këtu në këshill mban përgjegjesi për votën sepse përfaqëson një komunitet. Ju mund të na thoshit që në fillim që mbledhja fillon me materialet që janë miratuar një javë përpara. Ka pasur raste emergjente që nuk duhet të pranohen por kur bëhet fjala për bonus qeraje jemi social dhe I kemi pranuar. Kur bëhet fjalë për gjëra kaq të rëndësishme ku diskutohen interesa publike, prona publike une nuk jam dakor prandaj dhe vota ime është kundër..

Znj.Topa kjo situatë që ndodhemi sot e kemi sjell ne si Këshill Bashkiak e kemi lënë për të diskutuar në mbledhjen e radhës dhe ne e kemi vendosur bashkarisht që do të trajtohet në mbledhjen e radhës dhe ne sot jemi në mbledhjen e radhës.

Znj Biba: Kishte një arsye që e tërhoqëm edhe sot ne e sollëm prap sic ishte.

Z.Shyti : Kjo është bërë si e rrugëstë futim materiale dhe unë nuk jam përgatitur dhe për këtë arsye nuk jam dakort.

Znj.Kryetare: Tani që po diskutoni jeni kudër Projekt –Vendimit apo kundër futjes së materialeve? Po ju sqaroj edhe njëhere që ky Projekt – Vendim u shty dhe ne nuk mund ti fusim dokumentat nëqoftëse ato nuk vinin me datën përkatëse edhe kjo është arsyeja pse ju nuk e keni Projekt- Vendimin.Janë të njëjtat Projekt – Vendime tani vazhdojmë diskutojmë.

Z.Shyti: Pa material nuk diskutohet

Znj. Kamolli materialet janë të njëjta.

Z.Haxhillari: Ne jemi pjesë e pandarë nga komuniteti dhe ne I marim parasysh se çfarë do komuniteti. Këto dy Projekt – Vendime ne I kemi sjelle bashkë herën e kaluar dhe duhet të kalojnë bashkë. Problemi nuk ishte për kete Projekt-Vendim ishte për Fotovoltaikë. Meqë ne I diskutuam të dyja dhe I lamë që të dyja të shtyhen për mbledhjen e ardhshme.

Znj . Prifti : Ne gjithmonë që kemi shtyrë Projekt – Vendimet I kemi sjellë sërish dhe mua kjo gjithë më duket tendecioze. Jo unë kështu e shikoj 100% se fillova ta analizoj

Z.Shyti largohet nuk rra dakort për futjen e materialeve jashtë axhendës.

Znj. Kryetare : Projekt - Vendimet janë të njëjta vota na takon të gjithëve.


Z.Mancellari :Në dijeninë time ka një rregullore për fondet pyjore,frytore apo kullosore që ka cdo njësi Administrative apo Bashki.Në rradhë të parë ne nuk e dimë nëqoftë se ka ndryshuar destinacioni i asaj toke.

Znj.Kryetare : Është Projekt – Vendimi I rradhës ju lutem.

Z. Mancellari :Cfar të mira dhe benifiti I japin zones dhe a ka ndonjë raport studimi? Ju lutem shumë të jemi sa më të përgjegjshëm që të mos marim në qafë banorët e zonës.Unë propozoj që kjo sipërfaqe të jepet për kullotë për investim.Prandaj ju lutem të shofim interesat e banorëve.

Z. Male: Një tjetër arsye pse duhet të jem kundër është se përse fshihet kompania qe do të investojë.

Znj.Kryetare: Ju lutem janë dy Projekt – Vendime të ndryshme

Z.Male: Është e njëjta llogjikë.

Znj,Kryetar: jo nuk është e njejta llogjikë specifikohen.

Z. Haxhillari: Meqë nuk jemi dakort unë mendoj që ti shtyjme.

Z.Babasuli: Meqë ju Z.Mancellari nuk ishit herën e kaluar unë kam një vlerësim të tokës.

Z.Mancellari: Cfarë ka qënë ajo tokë? Sepse unë e njof zonën cfar ka qënë ajo tokë.

Z.Babasuli : Kanë qënë kullota dhe pemëtore.

Znj. Kryetare : Ju lutem po flisni për Projekt – Vendimin tjetër.

Z. Babasuli : Po I shpjegoj të dyja bashkë.

Znj. Kryetare: Jo të dyja bashke jane dy Projekt – Vendime të ndryshme.

Znj. Topa : Janë dy Projekt –Vendime të ndara.

Z.Mancellari: Po jane pemtëore.

Z.Babasuli: Cfarë thotë ligji eshtë se ti mund ta marësh në kullotë në tokë buqësore është bërë studimi dhe kemi parashikuar dhe menduar,sugjerojmë që të jepen me qerra për fotovoltaikë për dy arsye kryesore:

1.Janë toka që sperdoren.

2. Do I japi Bashkisë të ardhura të kënaqshme. Po flas për të dyja njëkohësisht.

Z.Mancellari: Unë jam plotësisht dakort që këto te jepen për pemtore frutikulturë ndërsa për fotovoltaikë të ketë një studim te ketë dicka që të bindemi ne që kemi dy pare shkollë.





Znj.Elezaj: Do të ketë problem për tokën

Z.Babasuli:As një lloj problem ajo do ketë problem mbas 35 vitesh kur do bëhet riciklimi I paneleve, un nuk e shof sot si problem dha pas 35 vitesh do ketë apo jo unë nuk mund ta them sot si problem.

Z.Mancellari: Për riciklimin.

Z.Babasuli: Riciklimin e ka për detyrë ta bëjë kompania që investon. Në rastin më të keq që do e braktisë sic ka ndodhur rëndomtë nëpër guroret.

Z.Mancellari: Për guroret sa për informacion ka një pagesë.

Z.Babasuli: Unë pot ë them që nuk e shof si problem , i vetmi problem që mund të diskutojmë është riciklimi por që për momentin nuk ka filluar akoma. Sepse akoma nuk ka kaluar cikli I atyre që janë instaluar.Unë po mundohem të jap argumenta pastaj gjykimi ju përket juve si Këshill. Meqë e njoj mirë këtë fushë besoj qe e njoj mirë këtë fushë kam mar përsipër që ti japim Bashkisë një shumë të konsiderueshme. Kjo ishte ideja për mendimin tim ne kemi cuar fatura fshatarëve të zonës edhe ata kanë thënë që ne nuk I kullosim bagëtitë unë kam cuar dy herë fatura dhe nuk kemi marë as një lek.

Z.Mancellari: Më fal atehere ky është gabimi I juaji sepse unë kam qënë vet në shërbimin Pyjor dhe vinin nga Gramshi për të paguar. Nëqoftëse ju nuk I dërgoni faturat ata nuk mund të paguajnë sepse ata ribursohen nga këto pagesa sepse pa mandatin qe ju dërgoni ata nuk marin ribursimin. Unë po habitem pse po ndoth dhe fai është përsëri I juaji dhe unë nuk doja ta thoja po ma nxorët, që këtë vit I keni cuar me vonesë dhe në kohën kur ju I keni dërguar nuk ka kullota. Ligji është miratuar që në Maj nëqoftë se unë nuk gaboju thoni që e kemi cuar në Korrik ne Gusht është tharë mali, prandaj shikoni gabimet ku janë.

Z.Haxhillari: Znj Kryetare meqënëse këshilltarët nuk janë dakort unë mendoj ti fusim edhe njëherë në mbledhjen e radhës.


Z. Mancellari: Ju lutem sa më shumë informacion dhe fakte për të mos I hyrë në hak banorëve.

Z. Male: Doja të pyesja a ka ndonjë pretendim nga banorët për kthimin dhe kompesimin e pronave sepse unë këtu kam një dispozitiv dt 17.10.2024 dhe pala paditëse Elez Muci. Atëhere duhet të shikoni shumë mirë për kërkesë padinë që është bërë.

Znj. Kryetare: Më falni për kë Projekt – Vendim e keni fjalën.

Z. Male : Për të dyja prandaj unë do ju lutesha ta shikoni me shumë kujdes për të mos bërë ndonjë padrejtësi.

Z.Torra: Ne ju kemi thënë edhe banorëve që kush ka ndonjë informacion ta paraqiti dhe deri më tani asnjë nuk është interesuar. Nëqotë se ai document është I regjistruar duhet të ishte





pasqyruar pranë ASHK që ajo pronë është e bllokuar është në process gjygsor. Deri më sot ne nuk kemi as një lloj dokumentacioni dhe unë jam shume dakort që aim und të jetë një pronar që pretendon për atë pronë, por ai duhet ta saktesoje dhe të sjelli dokumentacioni përkatës.

Z. Male: Për deri sa e gjej unë ju si nuk mund ta gjeni.

Z. Torra: Unë nuk mund të shkoj nëpër gjykata, unë kërkoj në zyrën e regjistrimit dhe në zyrën e regjistrimit janë të gjitha në rregull.

Znj. Olldashi: Dhe kjo ka qënë pika kryesore që është shtyrë, a ka raste ju lutem?

Z. Torra: Jo nuk kemi as një rast

Znj. Topa: Nuk dua të shtoj asnjë gjë nga parafolsit e mi por meqënëse nuk ka kërkesa dhe Z. Male thotë që ka në dorë ate informacion dhe ne marim një vendim kush do qoftë ai vendim për të mos bërë gabime propozoj të shtyhet për mbledhjen tjetër.

Znj. Kryetare: Kjo ishte Z. Prifti dhe arsyeja dhe nuk ishte aspak tendecioze. atëhere marim një vendim që të shtyhen të dyja Projekt – Vendimet. Unë po I lexoj edhe njëherë të ndara sepse kanë ndryshimet e tyre.

Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 35.5200 ha, të ndodhura në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qera. Hidhet në votim për shtyrje.

U votua

Pro 16

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo





Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09.2025

17. Miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkuar për ndërtim fotovolttaikë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 303259 m² (treqind e tremijë e dyqind e pesëdhjetë e nëtmijë) m².

Znj. Kryetare: E hedhim në votim për shtyrje.

U votua

Pro 16

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.09. 2025

18. Raportimin nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit për punën e kryer gjatë periudhës Janar-Gusht 2025 dhe planifikimet deri në muajin Dhjetor 2025.

Znj.Kryetare: I japim fjalën Z.Paskalino.

Z.Ziko: Përshëndetje jemi njoftuar nga Kryetarja e këshillit për të dhënë një informacion në lidhje me punën e Drejtorisë të kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit. Drejtoria përbëhet nga tre sektorë.

I.Planifikimi dhe kontrollit: Ky sektor meret me gjykimin e infrastrukturës ,ndryshim funksioni dhe cfarë pune ka bërë ky sektor gjatë vitit 2025. Po ju jap një informacion të shkurtër se cfarë pune ka bërë ky Institucin.

Kanë qënë 201 aplikime gjithsej, po themi mund të kenë qënë edhe të përsëritura që janë refuzuar dhe janë kërkuar përsëri. Deklaratë paraprake kanë qënë 148 aplikime ku 64 të miratuara 84 të refuzuara. Lejë ndërtimi janë 20, 7 të miratuara 3 të refuzuara dhe 10 në proces. Leje zhvillimi 46, 9 të miratuara . Sektori tjetër I Urbanistikes është sektori I Projekttimeve ku meret me të gjitha projektet. Pjesa më e madhe e projekteve që Bashkia ka miratuar janë bërë nga Drejtoria e kontrollit dhe Zhvillimit. Po listoj disa prej tyre, te gjitha rrugët ku një pjesë e mirë si Fshati Gështenjas,Rrëmënjë,Fshati Proptisht,rruga Qukës edhe punime nëpër shkollat që kanë përfunduar me sukses. Janë hartuar lumi I Bucimasit rrugët e qytetit fasadat e shtëpive edhe shumë punime të vogla të cilat nuk po I përmend. Kemi dhe sektorin e monitorimit të kontratave që kanë të bëjnë me të gjitha kontratat. I cili ky monitorim ndjek të gjithë bazën ligjore. Po listojme një listë të projekteve të colat janë në process dhe në monitorim.

Ura e Zëmcës

Rabilitimi I ujrave të zeza

Rikonstruksion për shkollën Kajo Karafili (që sapo përfundoi në Gështenjas)

Qendra multi funksionale

Infrastruktura në Bucimas dhe Infrastruktura rrugore

Banesat Sociale

Muret e Kalasë

Ndërtimin e murit Përroi I Caprrazit



Fasadat e rrugëve kryesore etj...

Kemi një ndërveprim me të gjitha institucionet që ndërveprojnë me njëra tjetrën për lejat e ndërtimit. Në vija të përgjithshme kjo është një rezymë e shkurtër. Jam i hapur për çdo pyetje konkrete që mund të kenë Këshilltarët.

Z.Haxhillari: Ne kaluam Buxhetin afatmesëm dhe ajo që ne na ran ë sy janë shpenzimet për Infrastrukturën që rriten në mënyrë të ndjeshme. Si paraqiten prespektivat në të ardhmen që lidhen me lejat e ndërtimit ka hapësira për këtë?

Z.Ziko: Ne ju jemi bazuar kërkesave të mëdha. Kemi dhe dy projekte të mëdha.

Z.Kryetara: Deklaroj mbledhjen e Këshillit Bashkiak të mbyllur

Protokolloi: Suela Markola.

Miratoi Projeshtin:

Sekretar e Këshillit

Jona Bojko *[Signature]*